



OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Data: 15/10/2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje uniforma, veshmbathje dhe element përbërës të tyre për Inspektorët e Kapitenerive, KSHF dhe KSHP”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

18100000-0 Veshje profesionale, rroba pune të veçanta dhe aksesorë

18110000-3 Veshje profesionale

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) **lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40%** e vlerës së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, pika 2/c e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar jo më e vogël se **40%** e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit.Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislationit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar dhe nenit 40 pika 4 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, në kushtet kur kjo procedurë prokurimi klasifikohet procedurë e hapur e thjeshtuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të ulët se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të ulët se 20 % të fondit limit, rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor i përmbushjes së kontratës dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik. Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor në bindje se Operatori ekonomik fitues përmbush dhe realizon me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001-2015 për “Sistemin e menaxhimit të Cilësisë” ose ekuivalente (e vlefshme) dhe të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të Ligjit të Prokurimit Publik, i ndryshuar , nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”indryshuar, është kërkuar kjo çertifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë çertifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e Autoritetit kontraktor të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të Autoritetit Kontraktor dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së.

3.Ofertuesi duhet të paraqesë Çertifikatë OEKO-TEX (standarti 100, kategoria II) ose ekuivalente me to, të vlefshme ,të prodhuesit të lëndës së parë të artikujve tekstile objekt prokurimi, për të vertetuar se lënda e parë e artikujve të ofruara nuk kane substanca të dëmshme për shëndetin dhe janë në përputhje me normativat e specifikuar të çertifikimit OEKO-TEX ose ekuivalente.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, me qëllim identifikimin e operatorëve ekonomik të cilët janë të autorizuar të shitjen e produkteve objekt të këtij prokurimi dhe lidhjen mes OE dhe prodhuesit. Çertifikata Oeko-Tex, Standart 100, është standarti që përfshin artikujt që kanë kontrakt direkt me lëkurën . Ky standart çertifikon produktet pasi janë të testuara për substanca të dëmshme për të mbrojtur shëndetin e njeriut (kimikate toksike). Çdo komponent i një produkti,që nga lënda e parë (metrazhi) e deri te aksesorët , duhet të jetë testuar rigorozisht kunder shume kimikateve toksike. Qëllimi i çertifikatës së tekstilit natyror është një praktikë miqësore me mjedisin dhe me përgjegjësi shoqërore që siguron një prodhim të qëndrueshëm,përfshirë etiketimin nga faza e prodhimit e deri ne zinxhirin përfundimtar të furnizimit,ndërsa konsideron sigurinë e produktit tek përdoruesi përfundimtar.

4.Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose te distributorit të autorizuar nga prodhuesi në rast se nuk është prodhues, për artikujt tekstile objekt prokurimi me nr.rendor 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,13 pjesë e Tabelës 1 (shtojca 7) si dhe për artikujt tekstile objekt prokurimi me nr.rendor 1,2,3,4,5 pjesë e Tabelës 2 (shtojca 7) . Operatori ekonomik ofertues në rast paraqitje autorizimi nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, website) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

5.Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për artikujt tekstile objekt prokurimi me nr.rendor 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,13 pjesë e Tabelës 1 (shtojca 7) si dhe për artikujt tekstile objekt prokurimi me nr.rendor 1,2,3,4,5 pjesë e Tabelës 2 (shtojca 7). Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë produktet e përzgjedhura, si dhe cilit katalog apo cilit prodhues i përkasin. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 40, pika 6 b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi. Në këtë rast është shumë e rëndësishme plotësimi i specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor pasi domosdoshmërisht duhet të garantojnë cilësinë e kërkuar dhe funksionalitetin gjatë përdorimit të tyre. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknik të kërkuar në DST me qëllim që komisioni të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

6.Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të mallit në adresën e autoriteti kontraktor përfitues.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të kryejnë transportin dhe montimin e mallrave objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta,

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme Detare, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Theksojme se afatet e levrimit janë kërkuar nga Autoritetet Kontraktore përfitues, sipas konsultimeve me operatorët ekonomik që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e shitblerjes së Uniformave ,veshmbathjeve dhe elementeve përbërës të tyre gjatë procesit të studimit të tregut.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

NJËSIA E PROKURIMIT